



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Nr. Prot.
 Dep. Br Prot.
 Dep. 20/DPK Prot No d-587/16
 Nr. i faq. Data
 Nr. pages 02 Date 12-02-2016

DATË/A:	12/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/564/16
PËR/ZA/TO:	z. Artan JAHA Shef i divizionit të Prokurimit në MBPZHR
CC:	z. Kapllan HALIMI Sekretar i Përgjithshëm në MBPZHR
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Larja e automjeteve të MBPZHR-së”

I nderuar z. JAHA

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Larja e automjeteve të MBPZHR-së” me numër prokurimi: 11303/016/001/236, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Larja e automjeteve të MBPZHR-së” me numër prokurimi:11303/016/001/236, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural keni iniciuar procedurën e prokurimit me titull: "Larja e automjeteve të MBPZHR-së" me numër prokurimi: 11303/016/001/236, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 08/02/2016 ku për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurën kuotim çmimi për shërbime.

Agjencia Kundër Korrupsion së pari ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim dhe pastaj gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë aktivitet, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në një kriter që është në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, pika III.4 KËRKESAT MBI MUNDËSINË TEKNIKE DHE/OSE PROFESIOANLE, KENI PARAQITUR kërkesë – "Vërejtje: Të nderuar OE ju njoftojmë se largësia e Autolarjes nuk mund të jetë më larg se 2 km nga AK MBPZHR" Me këtë kërkesë ju si Autoritet Kontraktues në Dosjen e Tenderit keni kufizuar konkurrencën e Operatorëve Ekonomik të cilët mund të ofrojnë shërbime në këtë diametër. Me këtë veprim, favorizoni operator të caktuar ekonomik dhe në të njëjtën diskriminoni të tjerë.

Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !